



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 44 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/ L- 040, nenit 3 paragrafi 1.3 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 38 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01-020/01-0050862/19, dhe nenit 25 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës, nr.01/146-11 të datës 29 prill 2010,

Në kërkesë të Nënkryetarit të Komunës, nr.prot. 01-060/01-0020049/20 të datës 30 mars 2020, sipas Shkresës nr.02-129/2 të datës 06.02.2020 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal,

THËRRAS


Mbledhjen e XXX-të (tridhjetë, mandati VI) – të jashtëzakonshme, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, e cila do të mbahet më **02 prill 2020, në Sallën e Teatrit të Qytetit “Avdush Hasani”**, në orën 10;00, me këtë:

Rend dite

➤ Masat për parandalimin dhe luftimin e Corona Virusit COVID-19

- Informatë rreth aktiviteteve, masave dhe menaxhimit të situatës nga Corona Virus COVID-2019
- Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë 125,000.00€, ndihmë qytetarëve në nevojë me pako ushqimore dhe hixhienike.
- Propozimi i vendimit për lirim nga taksa komunale e të gjitha Subjekteve afariste që ushtrojnë veprimtari në territorin e Komunës së Podujevës për vitin 2020
- Propozimi i vendimit për lirim nga pagesa e qirasë për të gjithë shfrytëzuesit e pronës Komunale për vitin 2020

Nr. 01-060/03-0020063/20
Podujevë,
30 mars 2020



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi